



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 37, datë 28.05.2015

MBI

**MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE
KËRKESAVE PËR PËRZGJEDHJEN E SHOQËRISË AUDITUESE PËR SHOQËRINË
E SIGURIMIT”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pikat 2 dhe 5, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si dhe të nenit 123, pika 6, të Ligjit nr. 52, datë. 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e rregullores “Për përcaktimin e kriterëve dhe kërkesave për përzgjedhjen e shoqërisë audituese për shoqërinë e sigurimit”, sipas materialit bashkëngjitur.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimin dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Enkeleda SHEHI